

Plani i ndërtimit të stallës

``Duke e parë me syrin e kafshëve``

Stallat e gjedhit të qumështit duhet të ndërtohen në mënyrë të tillë që të jenë të leverdisshme nga ana ekonomike, t'i përshtaten kafshëve dhe të jenë funksionale, duhet të jenë thjesht të mëdha dhe në skicën bazë duhet të ketë vend të mjaftueshëm dhe për ndërtimin e një impianti mjeljeje. Cilat janë kërkesat e lopës për stallën?

Ajri. Sa më i lartë të jetë rendimenti i qumështit aq më të preferueshme bëhen temperaturat e ulta për lopët. Stallat moderne duhet të jenë të ndërtuara në mënyrë të tillë që temperatura e brendshme e ndërtesës të ketë të njëjtën tempertaurë me ajrin e ambientit. Kur temperaturat e jashtme janë të larta, kryesisht gjatë periudhës së verës, freskimi i ambientit të stallës duhet të bëhet me anë të qarkullimit të ajrit. Në verë ajri duhet të qarkulloje nga 40 deri në 60 herë në orë dhe në dimër 4 deri në 6 herë në orë. Qarkullimi i ajrit është i nevojshëm sepse vetëm kështu mund të shmangim lagështinë, nxetësinë dhe krijimin e mikroorganizmave të dëmshme në stallë. Nëse ajri i konsumuar nuk del shpejt nga stalla, kjo sjell probleme tek kafshët. Tek stallat me ajrosje të lirë, duhet pasur parasysh që ndërtesa të ndërtohet në drejtim të erës me qëllim që në të të mund të qarkullojë ajër i pastër. Ndryshe nga njerëzit ,lopët nuk janë të ndjeshme ndaj ajrit te ambientit. Lopët durojnë një shpejtësi ere prej 3 deri në 5 m/sec, në verë ato janë të varura nga qarkullimi i ajrit, vetëm kështu ato mund të shmangin stresin e shkaktuar nga temperaturat e larta. Duke pasur parasysh strukturën e kafshëve, është e nevojshme që të ndërtohen sisteme ajrojseje fleksibël me fuqi ajrimi të lartë. Kështu ajrosja do t'i përshtatet nevojës së kafshëve.

Drita. Testime të shumta treguan që kohëzgjatja e ditës dhe intensiteti i dritës ndikojnë në rendimentin e qumështit. Optimale do të ishte 14 deri në 16 orë në ditë. Duke e parë nga ana ndërtimore, kjo do të thotë që mbulesa e stallës duhet të mundësojë një shfrytëzim optimal të dritës natyrore dhe të bëhet i mundur një menaxhim i duhur i dritës me intensitet prej afërsisht 200 lux. Kujdes me pllakat e çatisë që bëjnë të mundur hyrjen e dritës, sepse dielli mund të ketë efekt djegës mbi to dhe kjo rrit temperaturën në stallë. Prandaj këto pllaka duhet të vendosen në pjesën e poshtme të çatisë mbi murin e jashtëm.

Zona e ndenjes. Koha e fjetjes prej 12 orësh dhe më shumë, bën të mundur një ripërtyje intensive, kjo është e lidhur me sekrecionin e pështymës i cili bëhet gjithashtu me intensiv duke ndikuar pozitivisht tek plëndësi. Gjatë gjumit qarkullimi i gjakut në gjinjë të e lopës bëhet me intensiv dhe kjo përmirëson sintetizimin e qumështit. Një aspekt tjetër i rëndësishëm që arrihet gjatë gjumit është lehtësimi i thundrave, i tendinave dhe kyçeve. Nëse arrijmë që t'i ofrojmë lopës kushtet e kullotjes , pra hapësirën, sipërfaqen e nevojshme dhe qetësinë e saj, atëherë ajo mund të realizojë 12 orë gjumë.

Bokset e fjetjes (shtreterit). Forma e boksit, pavarësisht nëse është i lartë apo i thellë, luan vetëm një rol dytësor. E rëndësishme është që vendi i fjetjes të jetë i butë, i thatë dhe i ajrosur mirë. Pavarësisht

nga fakti se si është shtresa e boksit, vlen: bokse të larta me dyshek për lopë (i mbushur me kokrriza plastike) i mbushur me tallash ose kashtë të imët dhe me sipërfaqe mbështjellëse të depërtueshme, për një tharje më të mirë; ose bokse të thella me të paktën 10 - 15 cm kashtë, tallash ose rërë. I rëndësishëm është pastrimi i herë pas hershëm dhe nëerrimi i shtrojës me që bokset të jenë gjithmonë të pastër dhe të thatë. Bokset e thella kanë avanzh kundrejt boxeve të larta, sepse sigurojnë një komfort optimal.



Korridoret. Për të arritur rendiment optimal të qumështit lopët kanë nevojë për dalje të lirë tek ushqimi i freskët për gjatë 22 orësh. Korridoret mund të planifikohen duke iu përshtatur automatit të ushqimit (shtresa: beton ose asfalt) ose me dysheme me zgara; e rëndësishme është që dimensionet e korridorit të jenë të tilla që të lejojnë relativisht lëvizjen e lirë të kafshëve. Kjo do të thotë që korridoret e tagjisë dhe korridoret midis bokseve të fjetjes duhet të jenë të paktën 3 metër të gjera. Gjatë vendosjes së koritave dhe të automatit të ushqimit, duhet të bëhet kujdes që të mos krijohet rrugë qorre në stallë. Qarkullimi rrethor në stallë bën të mundur që lopët e një rangu më të ulët në hiarkine e krijuar, të mund të shmangen dhe të ruajnë distancën.

Grazhdi. Grazhdi duhet të jetë 10 deri në 25 cm më i lartë se vendi ku lopa rri, me qëllim që lopa të mund të hajë duke ulur dhe nxjerrë kokën para, pra e njëjta gjë si gjatë kullotjes në livadhe. Kur lartësia është 25cm, lopa ka mundësi të hajë pa iu dashur të hapë këmbët, dhe si rezultat i kësaj, gjërësia e grazhdit për lopë mund të jetë më e vogël. Grazhdi duhet të ketë një sipërfaqe të lëmuar dhe të ndriçuar (afërsisht 1 metër mbi zonën e grazhdit), sepse gjuha e lopës është veçanërisht e ndjeshme edhe ndaj aromave. Gjerësia optimale e grazhdit do të ishte 68 deri në 75 cm për çdo lopë. Përdorimi ose jo i një zgare varet në radhë të parë nga fakti nëse ekziston mundësia e ndarjes pas mjeljes. Ato

ferma të cilat i ndajnë rregullisht lopët e tyre duhet që të pajisin gjysmën e stallës së tyre me grazhdë dhe vendet e tjera t'i pajisin me qafore.

Për të vendosur makinat përzierëse të ushqimit, lugu i ushqimit duhet të jetë të paktën 5 metër i gjerë dhe i kalueshëm me makinë. Por gomat e makinës nuk duhet të kalojnë mbi ushqim.



Uji. Lopët e qumështit kanë nevojë për 4 deri në 5 litër ujë për çdo kg qumësht të prodhuar. Furnizimi me sasinë e nevojshme me ujë është një nga premiset kryesore për një rendiment të lartë qumështi. Për çdo grup lopësh duhet të ketë të paktën 2 mundësi për të pirë ujë. Për ato lopë të cilat duan të pijnë në korita, duhet të kujdesemi që këto të mos mungojnë dhe të mos vendosen në cepa ose rrugë qorre por në pozicione të tilla ku dhe pastrimi i tyre të jetë i lehtë dhe i shpejtë. (korita që mund të përmbysen). Thellësia 20 cm e ujit në një enë është e përshtatshme për lopët. Në rastin më ideal ajo duhet t'i ofrojë mundësinë kafshëve të pijnë në tre anë.